



Dalës Izlazna

Nr. — 1 — 22
Br.

Data 16.02.2023
Datum

OPILIC - OBILIQ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt. 26.01.2023, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Plhana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ibush Mjekiqi, Nënkyrytar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyrytar i Komunës për komunitete, drejtore komunal, përf. e OSBE-së, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, dhe qytetarët

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cili, pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Planit të menaxhimit të mbeturinave komunale 2023-2027
4. Shqyrtimi i Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre sipas rekomandimeve të Ministritës të linjave
5. Raporti vjetor i punës i Kuvendit komunal
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës dhe propozoi që në pikën 5 të rendit të ditës të futet plani i punës së Kuvendit për vitin 2023.

Miratohet rendi i ditës me 20 vota për me ndryshimin dhe plotësimin e cekur më lartë.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Ajet Berisha, me arsyé

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 12 vota për dhe 6 vota abstenum.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesueja – Paraqiti shqyrtimin e Draft planit të menahimit të mbeturinave komunale 2023-2027.

Enver Gashi – Ne si grup parlamentar i këtij Kuvendi jemi për që ky Draft plan të shkoj në dëgjim publik, pastaj kur kthehet në Kuvend, do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Edhe ne si grup parlamentar i LVV-së, jemi për që kjo Draft Rregullore të delë në debat publik, pastaj atje por edhe në Kuvend do të provojmë ta japim kontributin tonë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 20 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Draft planit të menaxhimit të mbeturinave 2023-2027.

Pika 4 e rendit të ditës –

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre sipas rekomandimeve të Ministrive të linjave. Ne në mbledhjen e KPF-së, kemi kërkuar që Komisioni të shkoj dhe të bisedoj me Ministrinë e financave për të ditur arsyen pse po kthehet në rishqyrtim që 2 herë kjo Rregullore. Komisioni ka biseduar me Ministrinë e financave dhe ata kanë dhënë një rekomandim që shpenzimet e parashikuara për realizimin e Rregullores të kordinohen brenda mundësive buxheore komunale të përcaktuara me Ligjin e buxhetit 2022 për Komunën e Obiliqit dhe varësisht nga mjetet e lira në dispozicion të bëjë edhe ndarjen e mjeteve për kategorinë e shpenzimit. Ju e keni marrë një njoftim prej Komisionit se Rregullorja nuk ka nevojë të votohet, por mbetet në fuqi ajo e dt.30.11.2022, vetëm se Komuna duhet ti parashehë me rishikim të buxhetit këto mjete ti ndajë për këtë kategori.

Enver Gashi – Ne nuk kemi çka me shtue, por kjo Rregullore le të shkoj me sugjerimet e Ministrisë gjegjëse. Ne edhe përpara e kemi paraparë buxhetin dhe do ti parashohim, por nuk mundemi fiks mi parapa shpenzimet e varrimit sepse nuk e dijmë saktë.

Sami Ahmeti – Ishte pikërisht kjo kërkesa jonë në mbledhjenn e KPF-së, që të merret një vlerësim prej Ministrive dhe kjo duhet të merret edhe si shembull edhe për Rregulloret tjera, qoftë edhe paraprakisht para se të miratohen që të merret pëlqimi, ose të merren rekomandimet e Ministrive gjegjëse, në mënyrë që mos të shkaktojmë këso telashesh kthim të Rregulloreve, rivotim. Më vjen mirë që veç është sqarue dhe kjo është një prej Rregulloreve shumë të rëndësishme për qytetarët e Obiliqit dhe shpresoj se herave tjera, nuk do të kemi këso telashesh.

Kryesuesja – Sqaron se problemi ka qenë vetëm te neni 12 ku është dashtë të përcaktohen mjetet prej nga merren, paraprakisht të ndahet një kod i veçantë nga Komuna të përcaktohen mjetet se janë për shërbimet e varrimit. Pra, ne nuk votojmë por mbetet në fuqi Rregullorja nr.-I-159, e dt.30.11.2022.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, ju planin e punës të Kuvendit, e keni pranue dhe Komisioni ka punue në këtë plan.

Enver Gashi – Ky plan i punës, duhet të bëhet çdo vit dhe e përgëzoj Komisionin, për punën e bërë. Shpresoj të na shkoj puna mbarë këtë vit më mirë se në vitin e kaluar dhe ne jemi për këtë plan.

Sami Ahmeti – Kryesuese, faleminderit fillimi shpëtimi për bashkëpunimin. Ne i kemi pasë 2 takime dhe punën më të madhe e ke bërë ti, kështu që të falenderoj. Në ndërkohë në këtë plan kanë hy ato çka janë prezentue prej Drejtive, çka planifikohet të zhvillohet gjatë këtij viti. Besoj se është një plan në vija të trasha në rregullë dhe në ndërkohë nëse, ka diçka si e tha edhe parafolësi normal që ne nuk mundemi me ditë se çka delë diçka e re dhe nëse, ka nevojë prapë plotësohet. Ne jemi për sepse është një plan që duhet të bëhet pothuajse i njejtë çdo vit me ndryshimet që parashihen.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 20 vota për e miratuan Vendimin për aprovimin e Planit të punës së Kuvendit komunal Obiliq, për vitin 2023.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Të nderuar anëtarë të Kuvendit komunal, lidhur me reportin vjetor të punës së Kuvendit komunal, unë mund të kemi gabuar ndokund, që është një raport i punës të cilin e kemi punuar bashkarisht. Dua të ju sqaroj se vendimet të cilat janë kthye në rishqyrtim, janë do të thotë ato vendime që nuk kanë prodhue efekt juridik sepse vendimet të cilat janë kthye për një fjali, apo kod ato vendime nuk përfshihen. Ne të njejtin raport e kemi dorëzue qysh në fillim të janarit në MAPL. Fjala rishqyrtim pse është konkretisht këtu, mbikqyret kryesuesi i Kuvendit dhe Ministria për vendimet që nuk prodhojnë efekte juridike nuk thotë se duhet të shfuqizohen sepse ia len në dorën e kryesuesit dhe kryesuesi nëse, nuk e paraqet te ju vendimin që nuk prodhon efekt juridik ndëshkohet vetë kryesuesi. Ju nuk e dini sepse ligjshmëritë nuk vijnë te ju, por vijnë në email të kryesuesit, por shpeshherë edhe me postë në formën fizike. Prandaj, kjo fjali e ka kuptimin e tillë, që në fakt janë 5 vendime që kanë ardhë gjatë vitit 2022 në rishqyrtim.

Enver Gashi – Kryesuese, të përgëzoj për punën tënde dhe tonën, që është punë e përbashkët. Shpresoj se ky vit do të jetë më i suksesshëm që me ra nën 5, e ndoshta edhe 0 vendime të paligjshme me u bë.

Sami Ahmeti – Realisht ky raport e thotë një numër simbolik, është numër i vogël i vendimeve të kthyera si tërësi. Në ndërkohë qysh e thatë edhe ju ka pasë vendime që është dashtë me i ndryshue pjesë të tyre. Kjo, kush punon edhe gabon kuptohet, por inkurajoj edhe zyrën ligjore dhe Drejtoretë që kur të sjellin Rregulloren sepse ne këtu, në Kuvend nuk jemi të gjithë të dijshëm. Në të gjitha Kuvendet zakonisht pozita vetëm voton qysh ti vjen nuk i lexon fare, në ndërkohë që dikush tjetër lexon pak më shumë. Unë i inkurajoj zyrat ligjore, pse jo edhe asambleistët që të lexojnë sa më shumë, në mënyrë që të prodhojmë dokumente që vërtetë, i hyjnë në funksion qytetarëve. Është një raport sa e kam lexuar unë është gjithëpërfshirës dhe kjo me 5, ose 6 vendime të kthyera nuk është që është jashtë normalës, mirëpo shpresojmë që herave tjera, të mos bëjmë gabime të tilla.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Unë jam munduar të ua dërgoj përgjegjet në kërkesat të materialit shtesë që është bërë, ndoshta me vonesë por atëherë është përgatitë materiali dhe e kam parë të arsyeshme se është më mirë ti keni edhe ju. Sa i përket kërkesës së Bashkësisë Islame, të cilën në KPF ia kemi rekomandue DPUPK-së, drejtori ka dhënë përgjegje dhe ju e keni parë.

Enver Gashi – Ajo që është me ligj është ligj dhe ne këtu, nuk mundemi me ndryshue ligjin sepse çdo Rregullore që e sjellim këtu, e sjellim në kuadër të kornizave ligjore.

Sami Ahmeti – Realisht ato që i kishim i thamë edhe në KPF dhe po e përsërisë kërkesa si e tillë ishte pak e paarsyeshme sepse nuk kishte arsyetim, fliste se është urgjente. Tani, e kuptuam se për xhaminë në Sibofc, është urgjente për shkak se pritet me u shpronësue ajo zonë megjithatë, nuk kishte arsyetime dhe duhet urgjentisht me u kthyë në emër të Bashkësisë Islame. Nuk është që kemi diçka kundër, por e vlerësoj përgjegjen e Drejtorisë, që është përgjegjë ashtu qysh e cakton ligji dhe kjo kërkesë sot nuk miratohet.

Kryesuesja – Ne kemi pasë edhe një kërkesë me shqyrtue të banorëve për një nënkalim poshtë te hekurudha, që është adresue në DSHPE dhe në Drejtorinë për infrastrukturë.

Kryetari – Ne i kemi marrë 2 kërkesa prej banorëve që janë nën hekurudhë, veç kanë fillue punimet e hekurudhës dhe ne kemi kërkuar nga hekurudha që urgjentisht ta organizojnë takim me qëllim që me i pa zhvillimet që do të ndodhin në Komunën tonë. Sipas informacioneve që kemi ata nuk kanë paraparë nënkalime, por duhet ti krijohet mundësia Komunës, që nëse parashohin nënkalime dhe dakordohen me hekurudhën që paraprakisht ato ti ndërtoj Komuna. Është fat i mirë që Komuna jonë renditet në mesin e 38 Komunave, në mesin e 3 Komunave me performancë edhe këtë vit më e mira, që në këtë rast Komuna jonë do të përfitoj një grand të planifikimit deri me 8 shkurt i këtij grandi për projekte të reja edhe pse planifikimin buxhetor për këtë vit e kemi bërë në vitin e kaluar. Neve, na u ka krijue një mundësi e re që projektet ekzistuese të vazhdojnë dhe shumë shpejtë në javën e ardhshme do të ulemi me hekurudhën për ta shikuar edhe një herë bashkarisht projektin e hekurudhës. Mendoj se fillimi duhet studimi i fizibilitetit se a mund të futemi nën hekurudhë dhe sa metra guxojmë të futemi nën të me qëllim që me pa mundësinë edhe për automjete me kalue, e nëse jo bile me bë për këmbësorë. Mirëpo, edhe nëse kjo mundësi nuk na krijohet duhet me shqyrtue mundësinë tjetër të mbikalimit.

Kryesuesja – E kemi një kërkesë nga anëtarë i Kuvendit, konkretisht aksionar në KRM “Pastrimi” dhe ne kemi punuar bashkë me zyren ligjore në atë propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve KRM “Pastrimi” dhe ua kemi dërguar edhe juve. Mjetet për kompensim do të merren nga mjetet vetanake të kompanisë KRM “Pastrimi”.

Enver Gashi – Ne këtë çështje e kemi diskutuar edhe në KPF dhe jemi për që ky vendim ti dërgohet kompanisë “Pastrimi” dhe ashtu si bëhet me aksionarët tjerë të Komunave tjera, le të bëhet edhe për tonën.

Sami Ahmeti – Kryesuese, paraprakisht lidhur me kërkesën e qytetarëve nuk na e dhe fjalën fare, do të thotë nuk hape debat fare lidhur me kërkesën e qytetarëve për nënkalimet nën hekurudhë, kështu që kërkoj mirëkuptimin tuaj vetëm një përbledhje të asaj që e kemi thënë.

Kryesuesja – Mundesh, pa telashe.

Sami Ahmeti – Edhe në KPF, ne e cekëm se prej se merremi me politikë shqetësimi kryesor i qytetarëve nën hekurudhë ka qenë një nënkalim dhe jo vetëm për udhëtarë, por edhe për automjete. E tha edhe Kryetari nëse, nuk e lejojnë kushtet currqysh me shkue shumë thellë për shkak të ujërave ka mundësi të jetë për banorë nënkalim. Në ndërkohë për automjete me qenë mbi hekurudhë qysh eshtë te rruga që shkon për Hade dhe në shumë vende tjera, krijojen kushtet për arsyen se kanë hall të madh dhe eshtë hall i krejtë atyre qytetarëve që iu bjen me u sjellë rreth e rreth. Ne jo vetëm që e dhamë si mbështetje, por jemi edhe të gatshëm qoftë si anëtarë të Kuvendit, që kemi qasje në Ministri të ndryshme, në këtë rast në Ministrinë gjegjëse të vijmë, të marrim pjesë edhe ne, ta japim kontributin tonë dhe qytetarëve, të iu realizohet kjo kërkesë. Kryetari i Komunës, eshtë institucion i cili e ka përgjegjësinë për gjithçka, por nëse veç ka nevojë prej grupit tonë, në këtë rast te Ministria gjegjëse ne jemi të gatshëm me dhënë kontributin tonë për arsyen se ky hall i qytetarëve eshtë shumë i madh. Dhe kjo mos të mbetet vetëm në nivelin e një deklarate se do të bëhet, por vërtetë le të zgjidhet sepse eshtë momenti se ka mundësi të zgjidhet, për shkak se hekurudha eshtë duke u punuar dhe derisa jemi në këtë fazë ka mundësi. Këtë, nuk e thashë as për kritikë, as për diçka tjetër, por e thashë për me shprehë vullnetin që në këtë pozicion besoj se kemi mundësi me ndihmues secili dhe ta shtyjmë përpara. Sa i përket pikës së rendit të ditës, për të cilën veç e mora fjalën pak ju kërkoj falje që dola prej saj, ne e kemi cekë edhe në KPF se jemi pro secila punë që bëhet prej anëtarëve të Kuvendit, aq sa e lejon ligji normal që të kompensohet sepse secili i ka punët e veta dhe secili i ka angazhimet e veta. Në takimin me juve, që e kam pasë konkretisht pikës për të cilën po flasim ne do të abstenojmë përfaktin jo që nuk jemi për me i ndihmues anëtarëve, por konsiderojmë se në këto Komisione të aksionarëve, kanë hy vetëm anëtarët e Ekzekutivit dhe nuk iu ka dhënë mundësia fare partive të tjera. Ne abstenojmë, por gjithsesi jemi që anëtarët të cilët angazhohen e kryejnë punë të ndryshme edhe të kompensohen.

Kryesuesja – Është një propozim vendim që nuk jam e sigurtë se aprovohet, ose lejohet prej Ministrisë por siç e kemi diskutuar edhe në KPF për anëtarët e Kuvendit të cilët janë në Komisione, eshtë mirë të zgjidhet ky problem dhe të paguhen për punën që e bëjnë. Thjeshtë, eshtë një propozim vendim që shumë Komuna që janë aksionar në të njejtën kompani, ata veç po u paguajshin për punën që e bëjnë dhe pse të mos paguhen edhe anëtarët e Kuvendit tonë, ata që janë të caktuar në Komisione tjera.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 6 vota abstenim e aprovuan Vendimin për kompensimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve të KRM “Pastrimi” SH.A. të emëruar me vendimin nr.-I-94, të dt.29.06.2022.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Në mbledhjen e KPF-së, e kemi diskutuar që mbledhjet të fillojnë prej ores 11 dhe Komiteti eshtë dakorduar që mbledhjet nga muaji shkurt të fillojnë nga ora 11. Aty, eshtë paraqitë kërkesa edhe prej anëtarëve të Kuvendit që mbledhjet e Kuvendit të fillojnë prej ores 11, e jo prej ores 10 sepse ata që punojnë po kanë telashe me ardhë me kohë. Unë e kam kontaktuar MAPL-në dhe përmes emailit iu kam bërë edhe një shkresë dhe Ministria eshtë përgjegjë se nuk eshtë aspak telashe dhe mirë që na keni njoftuar me kohë që të fillojmë monitorimin nga ora 11.

Anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht u pajtuan që duke filluar nga muaji shkurt mbledhjet e KPF-së dhe të Kuvendit komunal të mbahen në ora 11.

Kryesuesja – E kemi një kërkesë nga DMM-ja, bazuar në Rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave, është bërë një gabim teknik te tarifat kategoria e konsumatorëve shtëpiak nga 4.65 duhet të jetë 4.70 euro. Pra, kërkohet të bëhet ky ndryshim konkretisht te neni 10, pika 1.1.

Enver Gashi – Mendoj se është një gabim teknik i administratës komunale që nuk qon ndonjë peshë të madhe. Ky gabim teknik derisa ka nisë fakturimi nuk e ka parë askush dhe është aprovuar edhe prej Ministrisë, por shuma duhet të kthehet në 4.70 ashtu qysh ne jemi dakorduar në Kuvend.

Kryesuesja – Dua, të bëjë një përmirësim se nuk ka gabuar administratë Komunale, por Komisioni e ka sjellë te ne dhe ne ashtu si e ka sjellë Komisioni e përcjellim te ju.

Sami Ahmeti – Nëse, Rregullorja është miratuar në Kuvend për tarifa është miratuar me çmimin e gabueshëm, apo me çmimin që dojmë tash.

Kryesuesja – Përgjegjet se është miratuar me çmimin e gabueshëm 4.65.

Sami Ahmeti – Nëse, ne e kemi miratuar me 4.70, atëherë ne nuk kemi çka të diskutojmë vetëm se i rekomandojmë Drejtorisë që ta bëjë ndryshimin. Mirëpo, nëse ne e kemi miratuar me 4.65, atëherë me vendim duhet me shfuqizue atë pjesë dhe me rregullue. Kjo Rregullore kur është miratue.

Kryesuesja – Përgjegjet me dt.26.10.2022. Unë vetëm deshta të ju njoftoj se duhet të përmirësohet ky gabim teknik.

Shaip Paloja – Unë dua një sqarim nga DEFZH-ja, sa janë të prekur qytetarët tonë prej tatimit në pronë apo si është bërë vlerësimi nga Ministria, e zonave këtu në Komunën tonë. Nëse, mund të na sqaroni se a janë të prekur apo jo, banorët e Obiliqit me tatim në pronë.

Valbonë Beka – Unë i kam 2 kërkesa prej qytetarëve dhe njëra është për Mazgitin e Ulët për shkak se ndriçimi është dëmtuar shumë dhe pothuajse rruga është gati e pa ndriçuar. Kërkesa e dytë është prej banorëve të rr. "Hasan Hasani" që nuk e di se ku është problemi dhe a keni ndonjë plan për rregullimin e asaj rruge sepse qe sa kohë ata e kanë një rrugë që është shumë vështirë me kalue. Rruga është shumë e dëmtuar, e pa rregulluar, kështu që a e keni në plan me rregullue dhe kur.

Sami Ahmeti – Unë 2 pyetje që i pata në KPF, ato veç i sqaruam aty, kështu që ju falenderoj. Unë e kam një pyetje lidhur me një vendim që në Kuvend e kemi marrë për betonjerkën te lagjja "Aliu". Në fakt ne kemi marrë vendim që mos me shkue ai biznes përpara sepse kemi konsideruar se dëmton qytetarët. Pjes qysh është gjendja momentale sepse unë kam informacione se biznesi në fjalë po e vazhdon punën dhe është gati në funksionim e sipër. Unë kisha dashtë me ditë deri ku kemi ardhë dhe a ka ndërmarrë diçka Ekzekutivi lidhur me këtë çështje sepse si Kuvend kemi marrë një vendim, i kemi rekomanduar Drejtore që mos me lejue dëmtues më shumë të ambientit.

Kryesuesja – Ne vendim konkret nuk kemi nxjerrë, por kemi kërkuar nga DPUK-ja, DI-ja dhe DMM-ja, me i mbikqyrë, me dalë në terren me pa nëse, ata kanë leje ndërtimi dhe me na sjellë një raport.

Valon Svirca - Edhe unë e kisha të njejtën kërkesë si Valbona, nuk po e përsëriti hiç, te parku për rregullimin e drivate në Mazgitin e Ulët. Po ashtu, te rr. "Abdurrahman Gërguri" është një shtyllë e cila pothuajse është rrëzuar krejtë dhe një qytetarë ma ka dërguar një foto që nëse, mundeni me shkue me rregullue sepse është trotuar dhe mos po rrezikohet dikush.

Labinot Mirena – Unë e kam një propozim për aksionarët e NPL "Kastrioti" që të vazhdon ky vendimi për pagësë, do të thotë të paguhen edhe aksionarët që janë në NPL "Kastrioti" pasi që është kompani e njejtë.

Kryesuesja – Në këtë mbledhjen unë nuk kisha me shkue me vendim sepse ne duhet me i paraparë ligjet, nenet dhe me ardhë një propozim vendim i gatshëm në mbledhjen e shkurtit. Pra, me u thirrë në ligj në mënyrë që sa më pak me iu largue vendimeve që me na u kthye në rishqyrtim.

Ibush Mjekiqi – Sa i përket pyetjeve të parashtruara mund të them se janë prekë qytetarët e Obiliqit prej tatimit në pronë sepse norma tatimore nuk ka ndërrue, por është rritë vlera e pasurive. Ne si Komunë nuk e kemi të drejtën me bë vlerësimin e pasurisë, por është Drejtoria e posaçme në kuadër të Ministrisë së financave dhe mbi bazën e saj është rritë norma tatimore. Te ndriçimi në Mazgitin e Ulët, kjo është si rezultat i dëmtimeve që po vijnë nga vetë qytetarët dhe nga problemet tjera teknike që shkaktohen. Rruga

“Hasan Hasani” nuk e di saktë cila rrugë është dhe kemi bërë përpjekje maksimale në 3,4 vitet e kaluara dhe problemi është i pronës, prandaj deri në zgjidhjen e problemit pronësor ne nuk mund ta rregullojmë atë rrugë, por do ti shikojmë mundësitë tjera. Ajo rrugë ka mbetë pa u rregullue me asfalt vetëm për shkak të pronës sepse me zhavorr e kemi trajtuar disa herë. Te çështja e shtyllës, në vitin e kaluar në rr.”Abdurrahman Gërguri” është bërë ndriçimi dhe trotuari. Aksidenti i shkaktuar në trafik e ka shkaktue edhe atë shtyllë që ka mbetë në atë gjendje. Mirëpo, ne do të bëjmë përpjekje maksimale si të fillojnë punimet, që të rregullohet edhe ajo shtyllë. Ka qenë në proces gjyqjësor për shkak të dëmtimit të pronës, që ne edhe me pasë mundësi nuk kemi pasë të drejtë me ndërhy për shkak të procesit gjyqjësor. Sa i përket betonjerkës, momentalisht nuk mund të japë përgjegje, por në mbledhjen e radhës do ta keni një përgjegje.

Naim Miftari – Sa i përket betonjerkës, Drejtoria e inspeksionit vazhdimesh ka bërë inspektimin në atë zonë dhe është marrë rekomandimi nga Kuvendi, janë ndërmarrë të gjitha hapat duke përfshirë procesverbalet, shqiptimin e gjobave dhe vendimin për ndalim. Lënda është bërë edhe me kallëzim penal dhe është në Prokurori, kështu që e presim verdiktin e Prokurorisë, pastaj do të marrim hapa konform atij vendimi.

Sami Ahmeti – Pajtohem plotësisht, por ato janë hapa që as qytetarët, as ne nuk i shohim. Unë e kuptoj se Drejtoria duhet me bë punën e vet, është bërë një kallëzim penal, por në disa raste tjera, kur po bëhen disa ndërtime dikund po merren masa menjëherë, po ndalojen dhe nuk po lehen me shkue më tutje. Ne e dijmë që nëse, shkon një kallëzim penal, ose një padi i merrë 2,3 vjet dhe në ndërkohë subjekti këndej vazhdon punën dhe zhvillon aktivitete. Ne a kemi mundësi veç me dhënë vërejtje, apo edhe mundemi me marrë vendim, po flas Ekzekutivi komunal me i ekzekutue vendimet në mënyrë që derisa të merret vendimi i Gjykatës, ajo punë me u pezullue, mos me vazhdue mëtutje. Kjo, është arsyaja e pyetjes time për me ditë ku jemi. Kjo, nuk është pyetje me tendencë, por më intereson me ditë se a kemi ne mundësi, apo nuk kemi mundësi sepse nëse, kemi mundësi veç me shkrue dhe mos me ekzekutue kurgjë atëherë, nuk e di pse jemi.

Naim Miftari – Unë i shpjegova hapat që janë marrë nga Drejtoria e inspeksionit dhe qëndrojmë pas atyre hapave që i kemi marrë. Unë nuk mund të dalë mbi Prokurorinë, apo Gjykatën sepse nuk jam i thirrur me dhënë verdikt për atë çështje. Mirëpo, ne do ta presim vendimin dhe do ti marrim hapat konform atij vendimi.

Mbledhja përfundoi në ora 10:55'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal


Vlora Mjekiqi Kabashi

